



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë 28 / 12 /2020
Nr.Dok. 202001768/9

Lënda: Rekomandim lidhur me zbatimin e kërkesave të Naftëtarëve të Vlorës

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore,
Z.Drejtor

VLORË

Drejtuar: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Z.Sekretar i Përgjithshëm

TIRANË

Drejtuar: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës
Z.Sekretar i Përgjithshëm **TIRANË**

Të nderuar,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, ka paraqitur fillimisht një ankesë Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve, Vlorë, duke paraqitur shqetësimet e punonjësve për disa çështje të paraqitura si më poshtë vijon.

Pas regjistrimit të ankesës nga Shoqata e Naftëtarëve, Vlorë (SHNV në vijim), Avokati i Popullit i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesat plotësojnë të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe

përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/b, siç jeni në dijeni, ka vendosur të pranojë ankesën dhe ka filluar procedurën e shqyrtimit të çështjes.

RRETHANAT E RASTIT OBJEKT SHQYRTIMI

Shoqata e Naftëtarëve Vlorë shprehet se është përfaqësuese e rreth 650 përfituesve të statusit të naftëtarëve të cilët përsërisin për të disatën herë shqetësimin e tyre të vazhdueshëm për të cilin nuk kanë marrë përgjigje. Ata e parashtrojnë ankesën e tyre duke u shprehur se ligjet e miratuara nga Parlamenti dhe të botuara në Fletoren Zyrtare, konkretisht ligji nr.29/2019 datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji” (në vijim ligji nr.29/2019), neni 5, pika C dhe neni 14 dhe i ligjit nr.8/2017, datë 02.02.2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit” (në vijim ligji nr. 8/2017), nuk gjejnë zbatim.

Më pas shprehen se nga ana e institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shoqërisë Albpetrol sh.a. janë nxjerrë pengesa në dërgimin në kohë të të dhënave për të mundësuar miratimin e VKM-së për listimin e profesioneve, duke sjellë si rrjedhojë mosdhënien e vërtetimit të posaçëm. Gjithashtu, është e paqartë pse Komisioni Shtetëror pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE në vijim) ka pezulluar dhënien e dokumentit të Statusit të Naftëtarit për përfituesit. Shumë punonjës që kanë mbushur moshën 60 vjeçare të cilët janë larguar nga puna për shkak të përfitimit të pensionit (sipas profesionit) në zbatim të ligjit nr. 8/2017 dhe ligjit nr.29/2019, kanë më shumë se tre vjet pa punë dhe familjet e tyre pa të ardhura. Po kështu, shumë naftëtarë po largohen nga kjo jetë pa patur kënaqësinë dhe pa gëzuar të drejtën e përfitimit që nga muaji mars i vitit 2017.

ANALIZA DHE VLERËSIMI I VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA.

Fillimisht nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit i është kërkuar Shoqatës së Naftëtarëve të Vlorës “Informacion dhe dokumentacion shtesë” me kërkesë të përsëritur.

Me shkresën nr.prot.3942/1, dt. 24.07.2020 SHNV shprehet se “...shqetësimi i tyre vazhdon të jetë moszbatimi i ligjeve nr.8/2017 e nr.29/2019 si dhe i VKM nr.425, datë 10.05.2017 “Për rregullat e organizimit, funksionimit të komisionit për dhënien e dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të

posaçëm zyrtar”, dhe VKM Nr.721, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. Ato shprehen se edhe në përgjigjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE në vijim) nuk gjejnë përgjigjen e kërkuar, pasi ajo i drejtohet si përgjegjëse MIE dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë merret disi përgjegjësia por ende pa u zgjidhur problematikat. Shoqëria Albpetrol sh.a nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me pretendimet e tyre.

Kërkesat e tyre janë lidhur me zbatimin e ligjeve nr.8/2017 dhe nr.29/2019 si dhe VKM nr.425, datë 10.05.2017, dhe VKM nr.721, datë 11.11.2019. Ata kërkojnë të fillojë dhënia e vjetërsisë për personelin inxhiniero-teknik i cili nuk ka nevojë për listim dhe pjesa tjetër e naftëtarëve të cilëve ju duhet listimi të vijojë pas miratimit të listës së specialiteteve që duhet të trajtohet me VKM; kërkohet nga Albpetroli dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë të përfundojnë dhënien e vërtetimeve të posaçme dhe të përfundojë procesi i aplikimit për naftëtarët të cilët kërkojnë pension për shkak të profesionit; të përfundojë dalja e VKM për listimin e profesioneve sipas projekt-vendimit të dy ministrive; të përfundojë dhënia e Statusit të naftëtarit nga Komisioni në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Për shqyrtimin me objektivitet të ankesës dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me shkresën nr.prot K3/SH8-4, datë 09.07.2020, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Institutit të Sigurimeve Rajonale Vlorë dhe Shoqërisë Albpetrol sh.a. Argumentat e tyre si më poshtë vijon:

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Vlorë (DRSSH) me shkresën nr.prot 6251/1, datë 21.07.2020, shprehet ndër të tjera se “..... DRSSH Vlorë po vepron në zbatim të Ligjit nr.29/2019 si dhe të shkresës së ISSH Tiranë dalë për zbatimin e këtij ligji, me nr.prot 6035, datë 28.08.2019. Në lidhje me zbatimin e ligjit nr.8/2017 vlen të theksohet se pikat 1 e nenit 2, nenet 9,10,11,12, pika 1 e nenit 13 dhe nenet 14,15 janë shfuqizuar. Në lidhje me vërtetimet e posaçme të cilat kanë qenë detyrim ligjor që të lëshoheshin nga subjekti Albpetrol sh.a, DRSSH Vlorë, më datë 03.06.2020 ka marrë në administrim nga ky subjekt dokumentacionin dhe ka pranuar të gjitha kërkesat për pension për shkak të profesionit, i kaluar në përpunim duke bërë edhe kështu plotësimin e vërtetimit të posaçëm. Gjithashtu, bëhemi me dije se aktualisht janë paraqitur 916 kërkesa për përfitimin suplementar dhe 103 kërkesa për përfitimin e pensionit për shkak të profesionit. Bazuar në VKM

nr.447 dhe 448 datë 03.06.2020 po rishikohen të gjitha kërkesat e bëra në zbatim të ligjit nr.29/2019.

Me shkresën nr.prot 4485/1, datë 19.12.2017, Sigurimet Shoqërore Drejtoria Rajonale Vlorë, i dërgon SHNV listën emërore të 287 ish naftëtarëve të cilëve ju është nisur vërtetimi i posaçëm pranë MIE.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.prot 13205/2, datë 22.07.2020, shprehet ndër të tjera se “.....Shoqata e Naftëtarëve të Vlorës ka marrë përgjigje nga kjo ministri me shkresat nr.prot 4073/1, datë 03.03.2020 dhe me shkresën nr.prot 5084/1, datë 22.05.2020. Sqarojnë se në zbatim të ligjit 29, datë 23.05.2019, struktura e Institutit të Sigurimeve Shoqërore duke filluar nga data 01.09.2019 ka filluar regjistrimin e kërkesave dhe me miratimin e VKM-së nr.721, datë 11.11.2019 kanë filluar përlllogaritjen e përfitimeve. Ka filluar dhënia e përfitimeve dhe deri në këto momente janë caktuar përfitimet për 16.341 persona. Sipas klasifikimit është përcaktuar të marrin pension për shkak të profesionit apo shtesë mbi pensionin e pleqërisë rreth 23.000 persona të vlerësuar paraprakisht si përfitues sipas dispozitave të ligjit nr.29/2019. Gjithashtu është miratuar dhe VKM nr.447, datë 03.06.2020 *“Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të këshillit të ministrave, "për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni", të ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim- kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”, dhe VKM nr.448, datë 03.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”*. Përgatitja e listave që përmbajnë këto vendime është hartuar nga strukturat përkatëse teknike të MIE, e cila disponon dokumentacionin e organizimit të industrisë së naftës dhe historikun e ndryshimeve të herëpashershme të emërtimeve të ndërmarrjeve publike e private, duke bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e varësisë, shoqata dhe subjekte të tjera që janë pjesë e sistemit të industrisë së naftës dhe gazit. Lidhur me modhënien e vërtetimeve të posaçme nga Komisioni shtetëror pranë MIE, është përgjegjësi e MIE-s. Aktualisht funksionon një grup pune në MIE, i cili po merret në mënyrë eksplicite me hartimin e projekt-vendimit që do të trajtojnë këto çështje”.

3. Shoqëria Albpetrol sh.a me shkresën nr.prot 3942/1, datë 24.07.2020, shprehet ndër të tjera se “.....kjo shoqëri është angazhuar maksimalisht për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga punonjësit dhe ish punonjësit e industrisë së naftës në zbatim të ligjit 29/2019, si dhe vendimeve që kanë dalë në zbatim të tij. Shoqëria Albpetrol nuk disponon dokumentacion të vjetërsisë në punë të punonjësve nga momenti i themelimit

të saj dhe ky është shkaku i mos lëshimit të vërtetimeve të posaçme zyrtare për vjetërsinë në punë pranë shoqërisë përpara vitit 2013. Për periudhën që shoqëria disponon dokumentacionin bazë si regjistrat themeltar dhe listë-pagesat, ka vijuar normalisht me lëshimin e vërtetimeve për vjetërsinë në punë dhe bazën e të ardhurave për punonjësit e ish punonjësit në industrinë e naftës dhe të gazit, të cilët kanë paraqitur kërkesa. Për periudhën nga shtatori 2019 - në qershor 2020 janë lëshuar rreth 900 vërtetime për bazën e vlerësueshme. Është dorëzuar dhe dokumentacioni i vjetërsisë në punë që disponohet pranë DRSSH në Fier, Vlorë, Berat sipas kërkesës së DRSSH në zbatim të ligjit 29/2019 dhe VKM-së nr.721, datë 11.11.2019. Aktualisht shoqëria Albpetrol thekson se po trajton çdo kërkesë të ardhur nga punonjësit dhe ish punonjësit e industrisë së naftës duke lëshuar vërtetimet e kërkuara për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim.....”.

4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës me shkresën nr.prot 5268/2, datë 17.07.2020, duke na informuar së pari se kërkesave të Shoqatës i është përgjigjur me shkresat nr.prot 496/2, datë 29.05.2020, nr.prot 497/1, datë 29.05.2020 dhe përgjigje me emailin e datës 11.06.2020 për ankesën e kryer nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes çështja nr.199293, shprehet ndër të tjera se “ ... Komisioni i dhënies së dëshmimeve zyrtare identifikuese për punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit, vepron pranë MIE në zbatim të ligjit nr.8, datë 02.02.2017 dhe VKM-së nr.425, datë 10.05.2017, trajton kërkesat e aplikuesve dhe miraton dëshmitë zyrtare identifikuese për të gjitha profesionet në ndërrmarjet e industrisë së naftës dhe të gazit që janë të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar
Në zbatim të Ligjit nr.29, datë 23.05.2019, tashmë janë miratuar 2 vendime, VKM nr.447 datë 03.06.2020 ku përfshihet edhe personeli inxhiniero-teknik dhe VKM nr.448, datë 03.06.2020 në të cilat përfshihet edhe personeli inxhiniero-teknik.
Për zbatimin e nenit 8, të Ligjit nr.8/2017, të ndryshuar, shprehen se janë duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të nxjerrë udhëzimin përkatës.....”.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, i ka kthyer përgjigje SHNV, me shkresën nr.prot 1311/1, datë 11.03.2020, të cilët shprehen ndër të tjera se “...në pikën 2, të nenit 3, të Ligjit nr.29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës....” është përcaktuar se për efekt të përfitimeve nga ky ligj, vjetërsia në punë dhe periudhat e sigurimit në profesionet e punë në industrinë e naftës e të gazit do të njihen:
- periudha e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit, në profesione dhe punë të përcaktuara në Vendimin nr.526, datë 20.12.1958 të KM “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar.
- periudha e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit nga personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo

brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës e gazsjellës.

Nisur nga përcaktimet ligjore të sipërcituara për efekt të përfitimit nga ligji nr.29/2019 njihen periudhat në profesione dhe punë të përcaktuara në vendimin nr.526, datë 20.12.1958, i ndryshuar, ku dhe është mbështetur përzgjedhja e profesioneve që janë objekt i përfitimit nga ligji nr.29/2019, duke u bazuar në vështirësitë më të mëdha që shoqërojnë kryerjen e punëve në miniera... të dëmshme për shëndetin e punonjësve.

Lidhur me shqetësimin e SHNV për mosdhënie të vërtetimit të posaçëm nga shoqëria Albpetrol sh.a, bëjnë me dije se Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr.prot 6683/1, datë 24.10.2019 ka sqaruar Albpetrol sh.a se është detyrim i çdo subjekti të lëshojë vërtetimet përkatëse për llojin e punës së kryer nga punonjësit, sipas përcaktimeve në vendim.

Pasi kemi analizuar me kujdes edhe një herë shpjegimet e përcjella, konstatojmë se në shkresa shpjegohen edhe një herë rrethanat e rastit dhe përpjekjet për të çuar përpara proceset por pa patur rezultate pozitive përfundimtare të problematikave të tyre, të vërtetojnë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe kanë institucionet ndaj naftëtarëve në këto raste.

Në këtë kontekst, vlerësojmë se ka vend për përmirësim në qasjen që kanë institucionet ndaj shqetësimeve të naftëtarëve, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre. Sjellja e institucioneve përkundrejt naftëtarëve por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për të qenë sa më afër naftëtarëve. Do të ishte e ligjshme dhe e arsyeshme, në zbatim të parimit të transparencës dhe mirëqeverisjes, që institucionet e përfshira sipas shpjegimeve në këtë rekomandim të marrin masat e menjëhershme për zgjidhjen e kësaj problematike.

Në këtë këndvështrim, institucioni i Avokatit të Popullit sjell në vëmendje edhe përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *Keqadministrimi ndodh kur një organ publik nuk vepron në përputhje me një rregull apo parim i cili është i detyrueshëm për të.* Për më tepër, zbatimi me përpikmëri i ligjeve të miratuara nga Parlamenti është detyrë thelbësore e ekzekutivit, i cili duhet t'i zbatojë ato pa vonesa.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2 të nenit 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Ankesë/këkresat e SHNV lidhen me faktin që nuk gjejnë zbatim të Ligjit nr.29/2019 dhe të Ligjit nr.8/2017, të vendimit nr.721, datë 11.11.2019 dhe

të vendimit nr.425, datë 10.05.2017; institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shoqërisë Albpetrol sh.a kanë nxjerrë pengesa në daljen e VKM-së për listimin e profesioneve, rrjedhimisht në mosdhënien e vërtetimit të Posaçëm; Komisioni Shtetëror pranë MIE ka pezulluar dhënien e dokumentit të Statusit të Naftëtarit.

Për ankesë/kërkesat e parashtruara SHNV kërkon zbatimin e ligjeve dhe VKM lidhur me problematikat e parashtruara; të fillojë dhënia e vjetërsisë për personelin inxhiniero-teknik i cili nuk ka nevojë për listim dhe pjesa tjetër e naftëtarëve të cilëve ju duhet listimi të vijojë pas listimit me VKM; kërkohet nga Albpetroli dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë të përfundojnë dhënien e vërtetimeve të posaçme dhe të përfundojë procesi i aplikimit për naftëtarët të cilët kërkojnë pension për shkak të profesionit; të përfundojë dalja e VKM për listimin e profesioneve sipas projektvendimit të dy ministrive; të përfundojë dhënia e Statusit të naftëtarit nga Komisioni në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Shqetësimet e ngritura në këtë rekomandim duhet të trajtohen dhe adresohen në frymën e respektimit të ligjit dhe të drejtave e interesave të ligjshme të ankuesve dhe të vlerësohen në mënyrë maksimale dhe serioze duke ushtruar autoritetin shtetëror me qëllim trajtimin dhe zgjidhjen e tyre ligjore.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura në këtë rekomandim, ku del mëse e nevojshme përmbushja dhe zbatimi korrekt i dispozitave ligjore, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDON:

- 1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Vlorë,** të kryejë plotësimet për vërtetimet e posaçme për të gjithë kërkesat e naftëtarëve e në vazhdim, me ritme të shpejta brenda kapaciteteve të burimeve njerëzore;
 - T'i dërgohet SHNV-së lista emërore të ish-naftëtarëve të cilëve ju është nisur vërtetimi i posaçëm pranë MIE në mënyrë periodike;
 - Bazuar në VKM nr.447 dhe VKM nr.448 datë 03.06.2020, të rishikohen të gjithë kërkesat e bëra për përfitimin suplementar dhe për

përfitimin e pensionit për shkak të profesionit në zbatim të ligjit nr.29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxisë strukturat e varësisë për të përshpejtuar regjistrimin e kërkesave dhe përlllogaritjen e përfitimeve për pjesën e mbetur të naftëtarëve sipas klasifikimit të pensionit për shkak të profesionit apo shtesës mbi pensionin e pleqërisë në zbatim të VKM-së nr.721, datë 11.11.2019.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të trajtojë me prioritet çështjen lidhur me pezullimin/vazhdimësinë e pajisjes së naftëtarëve me dokumentat e statusit të naftëtarit të cilat jepen nga “Komisioni i dhënies së dëshmimeve zyrtare identifikuese për punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit” në zbatim të ligjit nr.8, datë 02.02.2017 dhe VKM-së nr.425, datë 10.05.2017, i cili trajton kërkesat e aplikuesve dhe miraton dëshmitë zyrtare identifikuese për të gjitha profesionet në ndërrmarjet e industrisë së naftës dhe të gazit që janë të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar;

- Të nxisë e monitorojë bashkëpunimin me MFE për të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të nenit 8, të Ligjit nr.8/2017, të ndryshuar.
- Shoqëria Albpetrol sh.a të angazhohet maksimalisht për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga punonjësit dhe ish punonjësit e industrisë së naftës në zbatim të ligjit nr.29/2019 si dhe vendimeve që kanë dalë në zbatim të tyre;
- Të vijojë me ritme të shpejta lëshimin e vërtetimeve për vjetërsinë në punë dhe bazën e të ardhurave për punonjësit e ish punonjësit në industrinë e naftës dhe të gazit, të cilët kanë paraqitur kërkesa dhe nuk kanë janë pajisur ende për vërtetimet e kërkuara për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim.

Lutemi që të njoftohemi brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi për masat apo veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente të sipërcituara.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISIONERI

Prof.As.Dr.Erjona BANA (CANAJ)